

## KODI I INTEGRITETIT DHE SJELLJES PROFESIONALE


Të nderuar kolegë.

Integriteti përbën bazën e biznesit të Grupit SGS dhe është e përbashkëta që përshkon gjithë aktivitet tona. Kodi i Integritetit dhe i sjelljes profesionale ka për qëllim përcaktimin e rregullave ne te gjitha marreveshjet per Grupin SGS dhe ofrimin e udhëzimeve në biznesin e përditshëm të shoqërisë.

Këto rregulla janë te vlefshme për të gjithë punonjësit e Grupit SGS, pa asnjë përjashtim. Madje edhe partnerët, agjentët, ndërmjetësit, këshilltarët dhe nënkontraktorët tanë duhet t'u binden këtyre rregulla. Zbatimi i rregullave të këtij Kodi është përgjegjësia e gjithsecilit prej nesh, në të gjitha nivelet e organizatës sonë. Ne nuk do të tolerojmë asnjë abuzim me interpretimin e përmbajtjes së tyre dhe asnjë punonjës nuk do të vuajë pasojat e respektimit të këtyre rregullave apo raportimit të abuzimeve apo shkeljeve të mundshme.

Kodi ynë i Integritetit dhe sjelljes profesionale reflektojnë parimet e biznesit në luftën kundër mitmarrjes, lëshuar nga Shoqata Ndërkombëtare e Transparencës dhe Përgjegjësisë Sociale. Sidoqoftë, ai shpreh vlerat dhe standartet tona pasi është aprovuar nga Bordi i Drejtuesve dhe Këshilli Operacional. Rregullat e tij janë mëse të thjeshta. Sidoqoftë, nëse ndeshni vështirësi në një situatë të veçantë, ju këshillojmë të veproni në bazë të parimeve bazë të mëposhtme:

- Mos kryeni asnjë veprim për të cilin keni dijeni apo besoni te jete i jashtëligjshëm ose jo etik.
- Mos përdorni asetet e shoqërisë për interesa personale.
- Mos ndërmerrni asnjë veprim financiar i cili nuk është i pastër dhe i ligjshem.
- Pyesni veten se në cilat raste një veprim financiar apo praktikë biznesi nuk do ti shpëtonte syrit kritik publik, nëse do të ekspozohet.
- Mos kryeni asnjë veprim për të cilin do të duhet të gënjeni.
- Kërkoni këshilla në rast nevojë.



Sergio Marchionne  
Presidenti i Bordit



Chris Kirk  
Drejtori Ekzekutiv

## **1. INTEGRITETI I SHËRBIMEVE**

Të gjitha shërbimet tona duhet të ofrohen në mënyrë profesionale, të pavarur, asnjëanëse, të ndershme dhe në perputhje të plotë me metodat, praktikat dhe politikat e aprovuara të Grupit. Ne nuk do të dorëzohemi në rast presioni nga klientët e një fushe biznesi me qëllim përfitim të një trajtimi të favorshëm në një tjetër fusheëbiznesi.

Çdo rezultat pune do të dokumentohet me kujdes dhe nuk do të ndryshohet në asnjë mënyrë. Raportet dhe çertifikatat do të reflektojnë me saktësi të plotë çdo rezultat pune dhe këshillim apo sugjerim profesional të marrë.

## **2. INTEGRITETI I TË DHËNAVE FINANCIARE DHE TË SHOQËRISË**

Të gjitha veprimet financiare duhet të ruhen me kujdes, sipas procedurave përkatëse dhe duhet të regjistrohen në librat financiarë të shoqërisë duke bashkangjitur edhe dokumentacionin përkatës të nevojshëm, leshuar nga palet, ne mirebesim. .

Këto regjistrime duhet të mbahen sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe politikave të Grupit.

## **3. KONFLIKTET E INTERESIT**

Një konflikt interesi lind në cdo situatë ku interesat e Grupit SGS janë të ndryshme nga interesat tuaja personale, të të afërmeve tuaj apo të personave të tjerë me të cilët keni marrëdhënie personale ose profesionale. Këto situata duhet të shmangen me çdo kusht pasi mund të ndikojnë në gjykimin tuaj objektiv, pa e vënë re as ju vetë. Madje, duhet të shmangni edhe shfaqjen më të parendesishme të interesave të konfliktit, pasi krijohet përshtypja se ju mungon aftësia e gjykimit të paanshëm.

Në vijim paraqiten disa shembuj të situatave ku ndeshen konflikte të interesit të cilat duhet të shmangen:

- Kryerja e një shërbimi për një person tek i cili Grupi SGS është i interesuar në mënyrë të drejtpërsëdrejtë ose jo.
- Përfitimi personal nga një mundësi biznesi e Grupit SGS ose përdorimi i asetëve apo burimeve të Grupit me qëllim përfitime personale.
- Pranimi i drejtëpërdrejtë ose jo i çdo favorit personal të ofruar nga punësimi në Grupin SGS, përveçse rastet që kanë për qëllim dhënien e dhuratave shoqërore brenda normave dhe veprimeve të mikpritjes.
- Përfitimi nga një furnizues, klient ose konkurrent i Grupit SGS përveçse në rastet e letrave me vlerë të tregëtueshme pa patur influencë të madhe dhe pa krijuar varësi si rezultat i kësaj marrëdhënie.
- Drejtimi i një zyre apo punësimi për një konkurrent apo klient të Grupit SGS apo edhe ofrimi i shërbimeve tek ta jashtë kuadrit të punës tuaj në grupin tonë.
- Pranimi i drejtimit të një zyre ose thjesht punësimi nga një shoqëri tjetër pa marrë lejen përkatëse.
- Kryerjen e cdo lloji biznesi të SGS-se, me një të afërmin tuaj ose një shoqëri tjetër me të cilën i afërmi juaj ka lidhje.
- Punësimi i një personi pa patur lejen përkatëse.

#### **4. PROKURIMI**

Prokurimi i mallrave dhe shërbimeve duhet të kryhet në mënyrë të drejtë dhe transparente me qëllim që të siguroje cilesine dhe cmimin me te mire ne një proces konkurrues me teper sesa lidhjen e kontratave të bazuara në preferencat personale.

Në raste të caktuara, porositë me një vlerë relativisht të lartë duhet të shqyrtohen dhe vendosen nga një grup i përbërë nga dy ose më shumë persona, pasi të jetë zbatuar procesi përkatës i tenderit.

#### **5. PËRFITIME TË PADREJTA**

Përfitimet e padrejta mund të jepen ose merren, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo.

Përfitimet e padrejta janë përfitime të dhena *per te ndikuar vendime apo veprime qeveritare* apo të korporatave, në kundërshtim me detyrat për të cilat personi është përgjegjës. Ato mund të kenë formën e bakshisheve, dhuratave, argëtimit i tepruar ose pagesave të fshehura. Ato përfshijnë gjithashtu kontribute politike, përveçse në rastet kur nuk janë të fshehura, në përputhje me legjislacionin lokal dhe janë miratuar paraprakisht.

Këto përfitime ofrohen kryesisht nga agjentë, ndërmjetës, këshilltarë ose kontraktorë të cilët pretendojnë të kryejnë një shërbim në mirëbesim (bona fide) ose në bashkëpunim sipërmarrje. Shoqëria jonë nuk pranon forma të tilla bashkëpunimi në rast se jemi të bindur ose kemi arsye të besojmë se këto përfitime do të çojnë në marrjen e përfitimeve të padrejta. Per me teper, për të shmangur çdo keqpërdorim fondëve monetare, çdo pagesë për mallrat apo shërbimet e blera do të kryhet tek personi përkatës duke shmangur gjithashtu edhe pagesat në kesh të cilat do të kryhen vetëm në rastet kur parashikohen nga procedurat përkatëse të Grupit. Pagesat e agjentëve, ndërmjetësve dhe këshilltarëve do të kryhen vetëm pasi është marrë aprovimi përkatës nga personat përgjegjës të shoqërisë.

Dhuratat, veprimet e mikpritjes dhe të argëtimit duhet të jenë gjithmonë të lidhura me një qëllim të ndershëm biznesi. Ato nuk duhet të tentojnë apo të duken si të tilla, që të ndikojnë në vendime apo veprime të ndryshme profesionale dhe duhet të ruajnë kufijtë e pranueshëm shoqërore dhe ligjore.

Ndihmat për veprime bamirësie dhe sponsorizime të ndryshme duhet të aprovohen paraprakisht nga personat përgjegjës.

Pagesat për lehtësi të ndryshme duhet të jenë pagesa modeste të cilat janë praktikë e lejuar në disa vende me qëllim përshpejtimin e veprimeve rutinë të përditshme. Këto lloje pagesash duhet të minimizohen dhe shmangen në çdo rast të mundshëm. Ato mund të kryhen vetëm nëse mund të vërtetohen veprimin e kryer dhe mund të llogariten përkatësisht.

#### **6. MARRËDHËNIET E PUNËS**

Grupi SGS është angazhuar t'u ofrojë të gjithë punonjësve të saj një ambient pune të shëndetshëm ku mbizotëron siguria e lartë, respekti reciprok dhe puna e ndershme. Shoqëria jonë nuk toleron në asnjë mënyrë diskriminimin apo ngacmime për arsye të racës, gjinise, nacionaliteti, aftësive të kufizuara, orientimi seksual, ose mosha.

Të gjithë punonjësit duhet të respektojnë kolegët e tyre. Ngacmimi seksual nëpër ambientet e punës nuk do të tolerohet në asnjë mënyrë. Punonjësit duhet të shprehen lirisht, të jenë transparent dhe të ndërtojnë marrëdhënie pune që bazohen në besimin reciprok midis kolegëve, vartësve dhe eprorëve.

#### **7. KONKURRENCA E DREJTË**

Ne jemi mëse të vetdijshëm për të mirat që sjell tregu i lirë dhe konkurrenca si një ndër mënyrat më efektive ne percaktimin e burimeve por ne zgjedhim konkurrencën e drejtë brenda kuadrit të dispozitave ligjore në fuqi.

Ne nuk hyjmë kurrë në diskutime apo lidhim marrëveshje me konkurrentët tanë me objekt çmimin apo selinë dhe nuk shkëmbejmë të dhëna të procesit konkurrues.

Ne kryejmë studime marketingu të shërbimeve të konkurrentëve tanë ose të palëve të treta në një mënyrë të ndershme dhe të drejtë. Ne reklamojmë dhe ekspozojmë veprimtarinë tonë tregtare në mënyrë të drejtë duke prezantuar rrjetin tonë të filialeve, burimet e përdorura dhe shërbimet e ofruara në mënyrë sa më serioze dhe të qartë.

## **8. RESPEKTIMI I LIGJEVE**

Ne jemi të angazhuar në respektimin e ligjeve në fuqi në vendet ku zhvillojmë veprimtarinë tonë. Punonjësit tanë do të jenë përgjegjës për të respektuar dispozitatat ligjore në fuqi dhe të kërkojnë ndihmë në çdo rast të mundshëm.

## **9. TREGTIA E BRENDSHME**

Të gjithë punonjësit duhet të mos pranojnë tregtimin e letrave me vlerë të lëshuara nga SGS Sh.a nëse kanë janë në dijeni të informacioneve private që nuk janë publikuar dhe që mund të kenë ndikim të drejtpërdrejtë ose jo tek çmimi i letrave me vlerë të SGS. Ndalohet gjithashtu nxjerrja e këtij informacioni konfidencial tek te tretet.

## **10. KONFIDENCIALITETI**

Sinqeriteti dhe transparenca janë vlerat thelbësore të Grupit SGS. Këto vlera mund të balancohen në raste të caktuara kundrejt detyrës së gjykimit të matur. Në fakt, disa të dhëna duhet të ruhen për të respektuar të drejtën e privatësisë së klientëve, bashkëpunëtorëve dhe punonjësve tanë, pa harruar të përmendim dhe interes e veprimtarinë tonë tregtare. Këtu përfshihet çdo informacion i cili nuk mund t'i jepet publikut të gjerë dhe që duhet të ruhet sekret, përfshirë sa më poshtë vijon:

- Të dhëna rreth aktivitetit të Grupit SGS, përfshirë të dhëna të klientëve, të dhëna financiare ose të tregut, metoda dhe procedura.
- Të dhëna në lidhje me palë të treta të cilat mbrohen nga deklarata të ruajtjes së konfidencialitetit.
- Të dhënat personale të punonjësve të grupit.

Këto të dhëna nuk duhet të jenë publike dhe nuk mund të përdoren për përfitime personale. Në rast se të dhënat rreth aktivitetit tregtar të Grupit SGS bëhen publike, atëherë shoqëria do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të ruajtur privatësinë e tyre. Të dhënat e palëve të tjera mund të bëhen publike vetëm në rast se pala përkatëse bie dakort paraprakisht.

## **11. IMPLEMENTIMI**

Kodi i Integritetit dhe sjelljes profesionale të Grupit SGS është hartuar nga Bordi i Drejtuesve të SGS Sh.a., i cili do të paraqese gjithashtu edhe rregulloren e implementimit të tyre sipas nevojës. Komiteti i sjelljes profesionale mbikqyr zbatimin e këtij Kodi dhe Drejtori i kontrollit kordinon zbatimin e tij, si dhe ofron udhëzimet përkatëse tek menaxheret dhe punonjësit e shoqërisë.

Të gjithë punonjësit duhet të zbatojnë rregullat e këtij kodi për të cilin ata do të informohen dhe do të trajnohen përkatësisht.

Çdo raport apo kërkesë që lidhet me zbatimin e këtij kodi duhet ti drejtohet Drejtorit të kontrollit. Ju duhet të raportoni tek Drejtori i kontrollit, ose tek eprorët tuaj duke kërkuar njoftimin e Drejtorit të kontrollit, çdo veprim që bie ndesh me rregullat e këtij kodi si dhe joshje apo ofertë nga ana e palëve të treta në mënyrë të pandershme për përfitime te padrejta personale. Ne do t'ju mbrojmë nga çdo masë ndëshkimore dhe do

të ruajmë privatësinë e të dhënave tuaja në çdo rast, përveçse kur ju shkelni rregullat e kodit ose veproni qëllimisht në dëm të shoqërisë, apo ne kushtet e keqbesimit.

Ne mirëpresim çdo sugjerim tuajin për implementimin e Kodit duke paraqitur idetë apo komentet tuaja tek Drejtori i kontrollit ose tek eprorët tuaj duke kërkuar që keto komente të percillen Drejtorit të kontrollit.

Ju mund të kontaktoni Drejtorin e kontrollit nëpërmjet postës, telefonit, faksit, postës elektronike apo shërbimit automatik të telefonit:

**Drejtori i kontrollit  
SGS SA**

1, Place des Alpes

P.O. Box 2152

CH – 1201 Geneva

Switzerland

Tel.: +41 22 739 91 00

Faks: +41 22 739 98 81

E-posta: [compliance@sgs.com](mailto:compliance@sgs.com)

**Tel. i shërbimit automatik: +1 888 475 6847**

*Për më shumë informacion për të na kontaktuar, vizitoni faqen tonë në internet në adresën [www.sgs.com](http://www.sgs.com).*

Kushdo, përveç punonjësve të shoqërisë SGS, mund të na kontaktojë në telefonat e mësipërm sipas nevojës.